

Tirana Auto
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2017



PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E PERFORMANCËS	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	4
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	5-19



TIRANA AUTO sh.p.k

NIPT: K82318007Q

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2017

në LEK

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	2,924,719	1,753,211
Llogari të arkëtueshme tregëtare	5	123,411,246	97,825,761
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	17,934,390	26,721,470
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	7,068,617	4,227,619
Inventarë	8	130,131,661	183,127,054
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	9	559,802	1,910,374
Total Aktive Afatshkurtra		282,030,435	315,565,490
Aktivet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	560,934,043	211,570,006
Të tjera llogari të arkëtueshme	11	-	-
Total aktive afatgjata		560,934,043	211,570,006
Total Aktive		842,964,478	527,135,495
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	12	143,208,812	72,391,310
Llogari të pagueshme tregtare	13	144,931,956	113,710,413
Detyrime tatimore	14	1,014,615	376,336
Parapagime të marra	15	21,659,459	31,129,586
Të tjera detyrime	16	30,000	4,707,474
Total Detyrime afatshkurtra		310,844,842	222,315,119
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	17	426,838,289	213,307,658
Total Detyrime afatgjata		426,838,289	213,307,658
Totali i detyrimeve		737,683,131	435,622,777
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	18	87,000,000	2,000,000
Rezerva ligjore		3,853,655	3,853,655
Rezerva të tjera		659,063	65,063,229
Fitimi i ushtrimit		13,768,629	20,595,834
Total kapitali		105,281,347	91,512,718
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		842,964,478	527,135,495

ADMINISTRATOR
BLEND LLACI

PERGATITI
MERITA GASHI

TIRANA AUTO sh.p.k.
TIRANA - ALBANIA

TIRANA AUTO sh.p.k

NIPT: K82318007Q

Pasqyra e Performances 31 Dhjetor 2017

në LEK

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	19	724,937,278	719,517,097
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	20	5,880,031	4,535,748
		(508,669,368)	(603,855,136)
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme			
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe shpenzime	21	(477,108,982)	(566,825,731)
2) Të tjera shpenzime	22	(31,560,386)	(37,029,405)
	23	(15,475,342)	(16,071,753)
Shpenzime te personelit			
1) Paga dhe shpërblime		(13,476,770)	(13,904,799)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(1,998,572)	(2,166,954)
Zhvlerësim i aktiveve afatgjata materiale			-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	24	(86,937,134)	(51,177,425)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	25	(71,429,238)	(3,372,410)
	26	(31,018,688)	(22,009,298)
Shpenzime financiare			
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(31,440,396)	(24,305,208)
2) Shpenzime të tjera financiare		421,708	2,295,910
Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit		17,287,539	27,566,823
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin			(6,970,989)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	27	(3,518,910)	(6,970,989)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		13,768,629	20,595,834
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		13,768,629	20,595,834



Tirana Autosh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Pashpërndara	Fitimet e Humbja e vitit	Fitim /	Totali
Pozicioni më 1 janar 2016	2,000,000	3,558,759	59,460,222	-	5,897,903		70,916,884
Transferim në rezerva të tjera		294,896	5,603,007		(5,897,903)		-
Totali i të ardhura gjithpërfshirëse për vitin: Emetimi i kapitalit të nënshkruar					20,595,834		20,595,834
Pozicioni më 31 dhjetor 2016	2,000,000	3,853,655	65,063,229	-	20,595,834		91,512,718
Transferim në rezerva të tjera	64,404,166		(64,404,166)		(20,595,834)		
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin: Emetimi i kapitalit të nënshkruar					13,768,629		13,768,629
Pozicioni më 31 dhjetor 2017	87,000,000	3,853,655	659,063	-	13,768,629		105,281,347

Pasqyrat financiare së bashku me shënimet shpjeguese për vitin ushtrimor të mbyllur më 31 dhjetor 2017 u aprovuan nga Administratori i shoqërisë më dhe u nënshkruan si më poshtë nga:

Z. Blend Llaci
Administrator



Merita Gashi
Përgatiti



Tirana Autosh.p.k*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	13,768,629	20,595,834
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	3,518,910	6,970,989
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	86,937,134	51,177,425
Fluksi i mjeteve monetare i përfshirë në aktivitetet investuese:		
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	-	-
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(21,807,741)	(40,330,072)
Rënie/(rritje) në inventarë	52,995,393	43,453,568
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	302,060,354	(61,923,603)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	437,472,679	19,944,141
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(507,730,409)	(7,657,541)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	71,429,238	3,372,422
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(436,301,171)	(4,285,119)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit		
Të hyra/(Pagesa e huave)		(30,167,110)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		(30,167,110)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	1,171,508	(14,508,088)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	1,753,211	16,261,312
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	2,924,719	1,753,224

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 19, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



4

Tirana Auto sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Tirana Auto Shpk është krijuar në vitin 2008, e rregjistruar në QKR me datë 18.11.2008. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit "Për Shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj.

Tirana Auto sh.p.k. është një shoqëri shqiptare, me ortak të vetëm Z. Benon Dede, shtetas shqiptar i cili zotëron 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë është 2,000,000 lekë.

Administrator i shoqërisë është Z. Blendi Llaci.

Selia e shoqërisë është : Autostrada Tiranë-Durrës, km 1, Rruga dytësore, Kashar, Tirane. Ajo është regjistruar pranë organeve tatimore të rrethit Tiranë me NIPT K82318007Q.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është import automjeteve, shërbim riparimi i tyre, servis universal.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015. Ky urdher hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

 



2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohej nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
Euro/LEK	132.95	135.23
USD/LEK	111.10	128.17



A blue ink signature.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivitetin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

 



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.



(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e AQT-ve	Norma e Amortiz në %		Metoda e llogaritjes
	2017	2016	
Toka	0 %	0 %	Mbi vlerën e mbetur të AAM-ve
Ndërtime e instalime	5 %	5 %	
Makineri e Pajisje	20 %	20 %	
Mjete transporti	20 %	20 %	
Pajisje zyre	20 %	20 %	
Pajisje kompiuterike	25 %	25 %	
Instrumenta dhe vegla pune	20 %	20 %	

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e cfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.






3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

 



Tirana Auto sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare në Arkë	191,904	321,507
Mjete monetare në Bankë	2,733,715	1,431,704
	<u>2,924,719</u>	<u>1,753,211</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Klientë	123,411,246	97,825,761
	<u>123,411,246</u>	<u>97,825,761</u>

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Ortaku	-	-
Hua nga subjekte te tjera	17,934,390	26,721,470
	<u>17,934,390</u>	<u>26,721,470</u>





Tirana Auto sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Tatim fitimi i parapaguar	3,908,776	2,263,605
TVSH		2,007,170
Te drejta te tjera	3,160,000	2,220,358
	<u>7,068,617</u>	<u>6,491,133</u>

8. Inventari

Gjendjet e inventarit më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Makina	99,435,854	154,592,719
Pjese kembimi	27,001,336	24,862,515
Inventar l imet	3,694,471	3,671,820
	<u>130,131,661</u>	<u>183,127,054</u>

9. Parapagime dhe shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Parapagime	-	-
Shpenzime te shtyra	559,802	1,910,374
	<u>559,802</u>	<u>1,910,374</u>



Tirana Auto sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive afatgjata materiale

	Ndërtesa	Mjete transporti	Të tjera	Totali
Kosto				
Gjendja më 1 janar 2016	1,410,883	363,485,212	10,445,779	375,341,874
Shtesa	-	7,147,288	510,253	7,657,541
Nxjerrje jashtë përdorimit		(10,125,900)		(10,125,900)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	1,410,883	360,506,602	10,956,032	372,873,517
Shtesa	-	507,485,975	244,434	507,730,409
Nxjerrje jashtë përdorimit		-172,564,477		-172,564,477
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,410,883	695,428,100	11,200,466	708,039,449
Amortizimi i akumuluar				
Gjendja më 1 janar 2016	41,360	112,877,857	3,960,358	116,879,576
Amortizimi i vitit	68,476	49,752,683	1,356,266	51,177,425
Nxjerrje jashtë përdorimit		-6,753,490		6,753,490
Gjendja më 31 dhjetor 2016	109,836	155,877,050	5,316,624	161,303,511
Amortizimi i vitit	65,052	85,885,689	986,393	86,937,134
Nxjerrje jashtë përdorimit		-101,135,239		-101,135,239
Gjendja më 31 dhjetor 2017	109,836	140,627,500	6,303,017	147,105,406
Vlera neto kontabël				
Gjendja më 31 dhjetor 2016	1,301,047	204,629,552	5,639,408	211,570,006
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,235,995	554,800,600	4,897,449	560,934,043



Tirana Auto sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(Vlerat janë në Lek)

11. Të tjera llogari të arketueshme

Gjate vitit 2017 nuk ka levizje te kesaj llogarie.

12. Hua afatshkurtër

Huatë afatshkurtra për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Hua nga Bankat (overdafte)	26,274,669	33,807,500
Hua nga subjekte te tjera	116,934,143	38,583,810
	<u>143,208,812</u>	<u>72,391,310</u>

13. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të pagueshme ndaj furnitoreve	144,931,956	113,710,413
Furnitore per fatura te pamberritura	-	-
	<u>144,931,956</u>	<u>113,710,413</u>

14. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe tap	457,380	289,161
Tvsh	557,335	87,175
	<u>1,014,615</u>	<u>376,336</u>

15. Parapagime të marra

Parapagime të marra më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Parapagime te marra	21,659,459	31,129,586
	<u>21,659,459</u>	<u>31,129,586</u>



Tirana Auto sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

16. Të tjera detyrime

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Detyrime te tjera	-	-
Paga dhe shperblime	30,000	-
	30,000	-

17. Hua afatgjatë

Huatë afatgjata për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Hua afatgjata nga bankat	101,751,715	138,931,158
Leasing	325,086,574	74,376,500
Të tjera	-	-
	426,838,289	213,307,658

18. Kapitali

	<u>31 dhjetor 2017</u>				<u>31 dhjetor 2016</u>			
	Kuotat	Vlera nominale	Vlera e kapitalit	Në %	Kuotat	Vlera nominale	Vlera e kapitalit	Në %
Benon Dede	100	870,000	87,000,000	100%	100	20,000	2,000,000	100%
	100	870,000	87,000,000	100%	100	20,000	2,000,000	100%

19. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shitje Automjete	464,990,919	542,468,206
Te ardhura nga leasing, qera	134,964,909	124,517,963
Te ardhura nga servisi	53,552,211	49,158,517
Te ardhura nga shitje aqt	71,429,239	-
	724,937,278	716,144,686



Tirana Auto sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

19. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
<i>Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne</i>	
<i>Qarkullim i tatueshëm</i>	715,467,151
<i>Parapagimet</i>	9,470,127
<i>Zbritet vlera kontabel neto e AAM-ve te shitura perfshire ne zerin "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit"</i>	-
<i>Shtohen diferencat e kursit perfshire ne zerin "Të ardhura të tjera të shfrytëzimit"</i>	5,880,031
<i>Shuma e qarkullimit e korrektuar</i>	730,817,309
<i>Sipas Kontabilitetit</i>	730,817,309
<i>Diferenca</i>	-

20. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar, rezultatin nga shitja e AAM-ve dhe të ardhura të tjerabalanca e së cilave më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Te ardhura nga qera automjete	-	-
Te ardhura nga shitje automjete, aktive (a)	-	-
Te ardhura te tjera	-	-
Fitim / Humbje nga kursi i këmbimit (b)	5,880,031	4,535,748
Të tjera shitje e shërbime	-	-
	<u>5,880,031</u>	<u>4,535,748</u>

a) Rezultati nga shitja e AAM-ve:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga shitja e AAM-ve	71,429,239	3,372,411
Vlera kontabël neto e AAM-ve të shitura	(71,429,239)	(3,372,411)
	<u>-</u>	<u>-</u>

b) Rezultati nga kursi i këmbimit

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Fitim nga kursi i këmbimit	9,787,352	7,465,034
Humbje nga kursi i këmbimit	(3,907,321)	(2,929,286)
	<u>5,880,031</u>	<u>4,535,748</u>



Tirana Auto sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(Vlerat janë në Lek)

21. Lënda e pare dhe materiale të konsumueshme

Materiale të konsumueshme dhe shpenzime të tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Mallra, automjete land rover	107,318,810	472,188,052
Mallra pjese kembimi, land rover	31,075,924	30,230,594
Mallra, automjete tata, mitsubishe etj	290,551,436	27,295,575
Shpenzime GPS	-	184,612
Siguracione automjete	29,191,210	15,141,331
Mirembajtje auto, taksa, transporte, doganore	18,971,602	20,459,990
Asistence, trainime dhe debit note	-	-
Mallra, automjete hyundai	-	-
Te tjera	-	-
	477,108,982	566,825,731

22. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime qeraje	11,211,334	10,725,000
Shpenzime postare e tel	461,117	535,356
Shpenzime bankare	584,665	1,048,078
Shpenzime te tjera, mirembajtje, kancel etj	1,331,757	767,635
Shpenzime te tjera, dhe rbs	1,282,160	2,848,523
Gjoha dhe demshpermbime	477,933	-
Mirembajtje e riparime	-	149,399
Shpenzime reklama, publicitet	-	-
Komisione dhe honorare	1,499,000	480,000
Udhetime e dieta	72,500	699,753
Shpenzime lende djegese	515,920	671,464
Shpenzim energji, avull, uje	868,217	523,180
Taksa dhe tarifa vendore	515,000	2,301,018
Te tjera nga shitje aqt, etj	2,980,218	-
Te tjera korente,	6,633,188	13,079,666
Shpenzime konsumi inventar I imet, llog 327	-	-
Shpenzime tvsh shitje aqt	-	-
Shpenzime komisione Ic dhe te tjera	3,127,377	170,028
Shpenzime pjes panaire	-	-
Humbje nga gabimet e lejuara	-	-
	31,560,386	33,999,100



Tirana Auto sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

23. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Shpenzime për paga	13,476,770	13,904,799
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,998,572	2,166,954
	15,475,324	16,071,753

24. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penaltetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Gjoha dhe dëmshpërblime	477,933	3,030,305
	477,933	3,030,305

25. Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat apo shpenzimet financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat dhe rezultatit nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërisë. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga interesat	822	3,153
Shpenzime për interesa	(31,441,218)	(24,308,361)
Shpenzime financiare	(31,156)	-
Të ardhura financiare	452,864	2,295,910
	(31,018,688)	(22,009,298)

26. Tatimi mbi fitimin

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Fitimi para tatimit	17,287,539	27,566,823
Shpenzime të panjohura si mëposhtë:	6,171,864	18,906,440
Shpenzime të tjera,		
Shpenzime udhetime e dieta etj	6,171,864	18,906,440
Fitimi i tatueshëm	23,459,403	46,473,263
Tatim fitimi 15% (2015: 15%)	3,518,910	6,970,989
Fitim / (humbja) e vitit	13,768,629	20,595,834